

VENDIM
Nr. 26, datë 27.3.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe neni 43 shkronja “c” të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 58 shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, nenit 59 pikat 2 dhe 3 dhe të nenit 60 pika 2 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 58, datë 5.5.1999, e ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) pas pikës 8.3.4 shtohen pikat 8.4 dhe 8.5 me përmbajtje si më poshtë:

“8.4. Pavarësisht përcaktimeve në pikat 8.1 deri në 8.3, banka rregullon totalin e aktiveve dhe të zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun, siç përcaktohet më poshtë:

8.4.1. Duke shtuar vlerën e rritjes që rezulton në krahasim me muajin mars 2013, të klasave në aktiv të bilancit “veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe “veprime me letrat me vlerë”, me jorezidentët në valutë (sipas formularit 7, bashkëlidhur rregullores), pasi të jetë zbritur vlera e shtuar e detyrimeve ndaj jorezidentëve në valutë që i përkasin të njëjtave klasa në atë periudhë raportuese;

8.4.2. Për vitin 2013, duke pakësuar me vlerën që rezulton nga një prej dy llogaritjeve të mëposhtme:

a) vlerën e rritjes së tepricës bruto të huas për klientët¹, të akorduar brenda vendit, në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, në krahasim me muajin dhjetor 2012, në rast se kjo rritje është më e madhe se 4 (katër) për qind dhe më e vogël ose e barabartë me 10 (dhjetë) për qind;

b) vlerën 10 (dhjetë) për qind të tepricës bruto të huas për klientët të akorduar brenda vendit, në muajin dhjetor 2012, në rast se rritja në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, është më e madhe se 10 (dhjetë) për qind.

8.4.3. për vitin 2014, duke pakësuar, me shumën e vlerës që rezulton nga llogaritjet sipas pikës 8.4.2 dhe vlerës që rezulton nga një prej dy llogaritjeve të mëposhtme:

a) vlerën e rritjes së tepricës bruto të huas për klientët të akorduar brenda vendit, në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, në krahasim me muajin dhjetor 2013, në rast se kjo rritje është më e madhe se 4 (katër) për qind dhe më e vogël ose e barabartë me 10 (dhjetë) për qind;

b) vlerën 10 (dhjetë) për qind të tepricës bruto të huas për klientët të akorduar brenda vendit, në muajin dhjetor 2013, në rast se rritja në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, është më e madhe se 10 (dhjetë) për qind.

8.4.4 Për llogaritjet sipas përcaktimeve të pikave 8.4.2 dhe 8.4.3 bëhen sipas formularit 8 bashkëlidhur rregullores.”

8.5 Nëse Banka e Shqipërisë nuk vendos ndryshe, pika 8.4 shfuqizohet në datën 31 dhjetor 2014. Me shfuqizimin e pikës 8.4, nëse banka nuk respekton nivelin minimal të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje ose përcaktimeve të tjera të Bankës së Shqipërisë, banka merr masa për të respektuar këto kërkesa deri në datën 30 qershor 2015.

b) formulari 4, i përcaktuar në pikën 7.4 të rregullores, ndryshon sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave në Bankën e Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit,

¹ Sipas sistemit raportues të unifikuar, përfshihen: “individët”, “njësitë tregtare dhe industriale private”, “njësitë tregtare dhe industriale publike”, “punonjësit e bankës” dhe “klientë të tjerë”.

për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani